



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 779/2 Prot.

Tiranë, më 26.10.2021

**V E N D I M**

Nr.132, datë 26.10.2021

**Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt vlerësimin e ligjshmërisë të procedurës së konkurrimit për pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Ligjore, Prokurimeve dhe Burimeve Njerëzore”, në Bashkinë Skrapar, nisur mbi bazën e disa pretendimeve të parashtruara nga shtetasi \*\*\*\*\*.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me pretendimet e ngritura nga shtetasi \*\*\*\*\*, për disa parregullsi të lejuara nga njësi përgjegjëse pranë Bashkisë Skrapar, gjatë zhvillimit të procedurës së konkurrimit për pozicionin “Drejtor Drejtorie”, në Drejtorinë e Shërbimeve Ligjore, Prokurimeve dhe Burimeve Njerëzore, pranë kësaj Bashkie,

**VËREJ SE:**

Nëpërmjet kërkesës së paraqitur nga shtetasi \*\*\*\*\*, pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e protokolluar me nr. 779 prot., datë 02.09.2021, ngrihen pretendime për disa parregullsi të kryera/lejuara nga njësi përgjegjëse pranë Bashkisë Skrapar, gjatë zhvillimit të procedurës së konkurrimit për pozicionin “Drejtor, në Drejtorinë e Shërbimeve Ligjore, Prokurimeve dhe Burimeve Njerëzore”, pranë kësaj bashkie, të shpallur në datë 22.11.2019, të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në fuqi që

rregullojnë këtë institut të shërbimit civil dhe shkelin parimin e barazisë dhe shanseve të barabarta të konkurrentëve.

Në përmbajtje të kërkesës së shtetasit \*\*\*\*\*\*, parashtrohet se, Bashkia Skrapar në faqen zyrtare online të saj dhe në portalin online Shërbimi Kombëtar i Punësimit, ka publikuar njoftimin për shpalljen e disa vendeve të lira të punës, përmes procedurave të lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, ku ndër pozicionet e shpallura është edhe pozicioni “*Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Ligjore, Prokurimeve dhe Burimeve Njerëzore*”, pranë kësaj Bashkie. Sa i përket procedurës së shpalljes dhe zhvillimit të fazave të konkurrimit për këtë pozicion pune, ankuesi ngre pretendime për parregullsitë e mëposhtme:

Së pari, publikimi në faqen zyrtare “online” të Bashkisë Skrapar, të shpalljes për konkurrim për pozicionin “*Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Ligjore, Prokurimeve dhe Burimeve Njerëzore*”, pranë kësaj Bashkie, është kryer në datë 10.12.2019, pra vetëm një ditë pasi ka përfunduar afati i pranimit të dokumentacionit për fazën e lëvizjes paralele për këtë pozicion pune, që ishte në datë 09.12.2019. Sipas ankuesit në këtë fazë të konkurrimit, nuk janë respektuar parimet e shërbimit civil, për shanse të barabarta dhe transparencë, pasi sipas tij, qëllimisht publikimi i njoftimit për shpalljen e pozicionit “*Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Ligjore, Prokurimeve dhe Burimeve Njerëzore*”, është kryer me vonesë në faqen zyrtare online të Bashkisë Skrapar, për të mospasur kandidatura për pozicionin në këtë fazë konkurrimi, e rrjedhimisht për të favorizuar kandidatin e parashikuar fitues në fazën tjetër të konkurrimit, atë të ngritjes në detyrë.

Së dyti, përbërja e Komitetit të Pranimit për Ngritjen në Detyrë (KPND), i ngritur për këtë procedurë konkurrimi nuk është në përputhje me kërkesat e Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”, i ndryshuar, të Këshillit të Ministrave, si dhe Udhëzimit nr. 02, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike, pasi në përbërje të këtij Komiteti nuk ka pasur përfaqësues të Bashkisë Skrapar.

Në këto kushte, ankuesi \*\*\*\*\*\*, ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për konstatimin e shkeljeve ligjore të ndodhura gjatë kësaj procedure konkurrimi, si dhe rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë në zbatim të kompetencave të ngarkuara nga ligji.

Në vijim, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pasi u njoh me pretendimet e mësipërme të ankuesit \*\*\*\*\*\*, përmes e-mailit zyrtar të datës 08.09.2021, me objekt: “*Kërkesë për dokumentacion për procedurën e konkurrimit për “Drejtor Drejtorie”, në Drejtorinë e Shërbimeve Ligjore, Prokurimeve dhe Burimeve Njerëzore*”, kërkoi nga institucioni Bashkia Skrapar, sqarime si dhe praktikën e plotë shkresore që disponojnë për

këtë procedurë konkurrimi, duke përfshirë dokumentacionin që materializon veprimet e kryera nga ana e këtij të fundit.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Skrapar, përmes e-maileve zyrtare me objekt “*Dërgim dokumentacioni*”, ka dërguar të skanuar të gjithë materialin e administruar në dosjen e konkurrimit për pozicionin në fjalë, duke e shoqëruar atë me sqarimet përkatëse.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga institucioni, sa i përket pretendimit të parë të ankuesit, në lidhje me respektimin e afateve të publikimit, rezulton se: Bashkia Skrapar me aktin nr. 4108 prot., datë 22.11.2019, “*Kërkesë për publikim vëndesh të lira*”, dërguar Shërbimit Kombëtar të Punësimit, ka kërkuar publikimin në portalin online Shërbimi Kombëtar i Punësimit, shpalljet për konkurrim për grupin e pozicioneve të lira, si më poshtë vijon:

- ✓ 1 Specialist/e IT, në Drejtorinë e Shërbimeve Ligjore, Prokurimeve dhe Burimeve Njerëzore;
- ✓ 1 Specialist/Jurist, në Drejtorinë e Shërbimeve Ligjore, Prokurimeve dhe Burimeve Njerëzore;
- ✓ 1 Drejtor/e, në Drejtorinë e Ekonomisë, Financës, Buxhetit dhe Tatim Taksave;
- ✓ 1 Inspektor/e i Ndihmës Ekonomike, në Drejtorinë e Ekonomisë, Financës, Buxhetit dhe Tatim Taksave;
- ✓ 1 Përgjegjës/e Sektori, në Drejtorinë e Shërbimeve Ligjore, Prokurimeve dhe Burimeve Njerëzore;
- ✓ 1 Drejtor/e, në Drejtorinë e Shërbimeve Ligjore, Prokurimeve dhe Burimeve Njerëzore;
- ✓ 1 Specialist/e Mjedisi, në Drejtorinë e Territorit, Kadastrës, Ujitjes;
- ✓ 1 Përgjegjës/e, në Drejtorinë e Territorit, Kadastrës, Ujitjes;
- ✓ 1 Përgjegjës/e Sektori i Ndihmës Ekonomike,

njëkohësisht ka publikuar shpalljen online në faqen zyrtare të Bashkisë Skrapar, nën rubrikën “*Punësim*”.

Referuar shpalljes së datës 22.11.2019, “*Shpallje për nëpunës civil, lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë për kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”, Bashkia Skrapar, në mbështetje të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe kreut II dhe kreut III, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 242, datë 18.03.2015, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”, i ndryshuar, ka shpallur procedurën e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë për pozicionin;

- ✓ “*Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Ligjore, Prokurimeve dhe Burimeve Njerëzore*”, kategoria e pagës II/b,

duke përcaktuar se, aplikimi bëhet njëkohësisht për të dyja fazat e konkurrimit, atë të lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, ndërsa afati për dorëzimin e dokumentave është data 09.12.2019 për lëvizje paralele dhe data 16.12.2019 për ngritje në detyrë.

Më tej, në përputhje me kërkesat e pikës 8, të kreut II dhe pikës 5, të kreut III, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*” i ndryshuar, dhe Udhëzimit nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike, në shpallje, janë parashikuar kushtet dhe kriteret e veçanta që duhet të plotësojë kandidati për të dyja fazat e konkurrimit; dokumentacioni i kërkuar, mënyra dhe afati i dorëzimit të dokumentacionit; rezultatet për fazën e verifikimit paraprak; fusha e njohurive, aftësive dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet testimi; mënyra e vlerësimit të kandidatëve; si dhe data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit.

Rezulton se, afatet e vendosura për zhvillimin e procedurës së lëvizjes paralele për pozicionin e punës “*Drejtor Drejtorie, Drejtorja e Shërbimeve Ligjore, Prokurimeve dhe Burimeve Njerëzore*”, janë në përputhje të plotë me kërkesat ligjore. Konkretisht, shpallja për këtë procedurë konkurimi është publikuar në datën 22.11.2019, në portalin online të Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe në datën 25.11.2019, në faqen zyrtare online të Bashkisë Skrapar, duke parashikuar afatin për dorëzimin e dokumentacionit datë 09.12.2019.

Referuar datave të publikimit online të shpalljes, konstatohet se janë respektuar kërkesat e pikës 9, të kreut II, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”, i ndryshuar, e cila parashikon se, dokumentacioni duhet të dorëzohet brenda datës së përcaktuar në shpalljen për konkurrim, dhe se afati i dorëzimit të dokumentacionit duhet të mos jetë më i vogël se 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes, në portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit, në faqen zyrtare të internetit dhe në stendat e informimit të publikut, për institucionet e vetëqeverisjes vendore.

Në vijim të procedurës së kësaj faze konkurimi, njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Skrapar me e-mailin e datës 12.12.2019, ka dërguar për publikim pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit si dhe në faqen zyrtare online të Bashkisë, rezultatin e verifikimit paraprak të konkurrentëve për lëvizje paralele, për pozicionin “*Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Ligjore, Prokurimeve dhe Burimeve Njerëzore*”, ku rezulton se për këtë fazë konkurimi nuk ka pasur kandidatë, si rrjedhim pozicioni mbetet i hapur për fazën tjetër, atë të ngritjes në detyrë. Ky informacion i është dërguar SHKP edhe përmes shkresës me nr.4379 prot., datë 16.12.2019, të Bashkisë Skrapar.

Më tej, me shkresën nr. 4421 prot., datë 18.12.2019, “Kërkesë për publikim”, dërguar Shërbimit Kombëtar të Punësimit, është dërguar lista e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë, për pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Ligjore, Prokurimeve dhe Burimeve Njerëzore”, që është kandidatja \*\*\*\*\*; në përputhje me pikën 3, të kreut III, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” i ndryshuar, duke respektuar edhe kërkesat e pikës 4, të këtij vendimi, e cila sanksionon se shpallja e procedurës për ngritjen në detyrë, botohet të paktën 35 ditë kalendarike para datës së parashikuar për zhvillimin e vlerësimit.

Nga përmbajtja e dokumentacionit të konkurrimit, rezulton se deri në këtë fazë të zhvillimit të procedurës së konkurrimit për pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Ligjore, Prokurimeve dhe Burimeve Njerëzore”, nga ana e njësisë përgjegjëse pranë Bashkisë Skrapar janë respektuar të gjitha kërkesat e parashikuara nga aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këtë aspekt të legjislacionit të shërbimit civil, të cituara në material si më lart.

Së dyti, në lidhje me pretendimin tjetër për parregullsi në përbërjen e KPND-së, në pikën 7, të kreut III, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar, parashikohet se Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyrë (KPND), ka në përbërje 5 (pesë) anëtarë, si më poshtë vijon:

- a) 1 (një) anëtar nga njësia përgjegjëse, i cili kryeson komitetin;
- b) 1 (një) anëtar i zgjedhur nga titullari midis nëpunësve civilë të institucionit, nëse është e mundur të nivelit të mesëm drejtues;
- c) eprorin direkt të pozicionit, për të cilin zhvillohet konkurrimi;
- ç) 2 (dy) ekspertë të fushës përkatëse, në varësi të fushës së vlerësimit.

Në rastin në fjalë, me Urdhrin nr. 212, datë 12.12.2019, “Për ngritjen e Komitetit të Pranimit për Ngritjen në Detyrë”, (nr. 4339 prot., datë 12.12.2019), është ngritur Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyrë, me këtë përbërje:

- a) \*\*\*\*\*; e komanduar “Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore”, me aktin nr.163, datë 01.10.2019, si përfaqësuese e njësisë përgjegjëse, Kryetar;
- b) \*\*\*\*\*; me detyrë “Specialist i Financës”, nëpunës civil;
- c) \*\*\*\*\*; me detyrë “Nënkryetar i Bashkisë Skrapar”, në cilësinë e eprorit direkt të pozicionit të shpallur;
- d) si dhe në cilësinë e eksperëve të fushës \*\*\*\*\*; (Eksperte Ekonomie) dhe E.Pogaj (Ekspert Jurist).

Referuar përbërjes së KPND-së, rezulton se, kemi të bëjmë me mosplotësim të gjithë kërkesave të pikës 7, të kreut III, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, i ndryshuar, të Këshilit të Ministrave, pasi në cilësinë e anëtarëve të KPND janë vendosur dy punonjës të bashkisë të cilët nuk gëzonin ose nuk e gëzonin në nivelin e kërkuar, statusin e nëpunësit civil (\*\*\*\*\*, i emëruar n/kryetar bashkie dhe \*\*\*\*\*, e komanduar në një pozicion të nivelit të ulët drejtues).

Mirëpo, nisur nga fakti se, në Bashkinë Skrapar në momentin e realizimit të procedurës së konkurrimit ka pasur një mungesë të theksuar të nëpunësve të cilët gëzonin statusin e nëpunësit civil, fakt ky i evidentuar edhe më parë nga Komisioneri, (*shih Vendimin Paralajmërues nr. 154, datë 05.12.2019, i KMSHC*), në rastin konkret kjo mospërputhje nuk passjell cënim apo patjetër pavlefshmëri të procedurës së konkurrimit, për aq kohë sa janë respektuar të gjitha kërkesat e tjera për kryerjen e fazave të ndryshme të konkurrimit, të materializuara këto në aktet e hartuara dhe miratuara nga KPND-ja, të cilat janë pjesë e dosjes së hetimit administrativ; si dhe faktit që kandidati i shpallur fitues në përfundim të procedurës së konkurrimit, i plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret për pozicionin e plotësuar. Për më tepër, KPND është organ kolegjal dhe si i tillë, në bazë të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999, “*Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike*” i merr vendimet me shumicë votash. Duke qenë se shumica e anëtarëve të KPND, i kanë cilësitë e kërkuara nga legjislacioni i shërbimit civil, shkelja e mësipërme përbën kundërligjshmëri, por nuk sjell pavlefshmëri të akteve administrative të prodhuara.

Megjithatë, Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Skrapar duhet të tregojë kujdes në vijim, duke pasur parasysh që nëse ndodhet përpara rasteve të mungesës së punonjësve në pozicione të caktuara, pjesë e organikës së kësaj Bashkie, të cilët për shkak të pozicionit të tyre të punës, thirren në përbërje të Komisioneve apo Komiteteve të ndryshme të ngritura pranë këtij institucioni dhe ndodhet në pamundësi për zëvendësimin e këtyre punonjësve me punonjës të tjerë brenda Bashkisë, atëherë nisur nga fryma e legjislacionit për shërbimin civil, i konceptuar si një i tërë, përbërja e Komisioneve/ Komiteteve në këtë rast, duhet të plotësohet nga nëpunës civil me nivelin e kërkuar të nëpunësisë, nga njësi fqinje të qeverisjes vendore, që punësojnë nëpunës civil, në të njëjtën linjë të hierarkisë.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, si dhe në mbështetje të nenit 16, pika 6, e Rregullores, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

## **VENDOSA:**

1. Përfundimin e hetimit administrativ, filluar në bazë të ankesës nr. 779 prot., datë 02.09.2021, të paraqitur nga shtetasi \*\*\*\*\*, me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së shkeljeve të pretenduara se janë kryer ose lejuar gjatë zhvillimit të procedurës së konkurrimit për pozicionin “*Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Ligjore, Prokurimeve dhe Burimeve Njerëzore*”, në Bashkinë Skrapar dhe arkivimin e çështjes.
2. Të mbahet parasysh dhe të mos përsëritet në të ardhmen, shkelja e përshkruar në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, në lidhje me përbërjen e Komitetit të Pranimit të Ngritjes në Detyrë.
3. Të njoftohet për këtë vendim institucioni Bashkia Skrapar dhe shtetasi \*\*\*\*\*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**